

## V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2012

### Mbi

#### **Miratimin ne parim të letër marrëveshje ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)**

Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 15.10.2012 pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive mbështetur në;

Ligjin Nr.9130, datë 08.09.2003, "Për Autoritetin Portual", neni 15, dhe neni 18 pika d,;  
V.K.M. Nr. 596 datë. 10.09.2004 "Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij", të ndryshuar;

Vendimin nr 10, datë 18.07.2011 "Mbi miratimin në parim të marrjes së kredisë për financimin e projektit të thellimit të kanalit hyrës dhe basenit në portin e Durrësit"

Vendimin nr 32, datë 15.12.2011 "Mbi miratimin e kritereve të vlerësimit të propozimeve të kredisë për financimin e thellimit të kanalit hyrës dhe basenit në portin e Durrësit"

Vendimin e Këshillit Drejtues nr 24 datë 15.03.2006 "Mbi miratimin e Rregullores së Këshillit Drejtues" të ndryshuar; neni 16,

Me qëllim vazhdimin e negociatave me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) per kushtet e financimit të projektit të Thellimit të Portit të Durrësit:

### V e n d o s i:

1. Miratimin në parim të Letër Marrëveshjes të propozuar nga Banka Europiane për rindërtim dhe zhvillim (EBRD) datë 10 tetor 2012, nr prot 2897 datë 11.10.2012, me qëllim vazhdimin e procedurave nga Banka per kushtet e kredisë për "Projektin e thellimit të kanalit hyrës në portin e Durrësit" dhe autorizimin e Drejtorise Ekzekutive për nënshkrimin saj.
2. Shpenzimet që rëndojnë për Autoritetin Portual Durrës sipas kësaj marrëveshje të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion për shpenzime bankare.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekzekutive e APD-së për zbatimin e këtij vendimi.

**SEKRETARE**  
**Iva CARA**

**KRYETARI**  
**Ervin MINAROLLI**  
**Anëtarët**  
**Mirela HASANAJ**  
**Genc MATAJ**  
**Ylli DYLGJERI**  
**Adrian ÇELA**  
**Agim MAKSUTI**